



Republika e Kosovës  
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Kryetari i Komunës  
Nr. 01/011-202076  
Më 17.11.2015



Komuna e Prizrenit  
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b dhe m të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, kryetari i Komunës, më 17 nëntor 2015 mori këtë:

#### V E N D I M

1. Miratohet propozimi i Drejtorisë së Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, bazuar në kërkesën e Besim Gjashtëgjishtit, i evidentuar si rast social, për lirimin nga pagesa e kontributeve për rregullimin e tokës ndërtimore (taksat për leje ndërtimore-komunalive) lidhur me ndërtimin e shtëpisë familjare të banimit të tij. Kështu që, obliguesi i kësaj takse, Besim Gjashtëgjishtit, lirohet nga taksa e lartcekur, e cila i është caktuar nga shërbimi kompetent i Komunës.
2. Lirimi nga pagesa e kontributit për rregullimin e tokës ndërtimore (taksat për leje ndërtimore-komunalive), e cila është llogarit në shumën prej 270.25 €, konsiderohen si participim (donacion) i Komunës së Prizrenit për ndërtimin e këtij objekti.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.
4. Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, i lartcekuri si dhe Arkivi.
5. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës  
Prof. dr. Ramadan Muja



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti**

**Komuna e Prizrenit**  
**Opština Prizren – Prizren Belediyesi**

Kryetari i Komunës

Nr. 01/06-199281

Më 17.11.2015

Kryetari i Komunës në mbledhjen e mbajtur më 17 nëntor 2015 me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Administratës, për lejimin e shpalljes së tenderit për servisimin e autoveturës Mercedes –Benz, që është në pronësi të Komunës së Prizrenit, dhe mori këtë:

#### K O N K L U Z I O N

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Administratës, për lejimin e servisimit dhe riparimit të autoveturës Mercedes –Benz, që është në pronësi të Komunës së Prizrenit dhe që shfrytëzohet për shërbimet e kryetarit të Komunës së Prizrenit, kështu që, për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen: Drejtoria e Administratës-Spektori Teknik, Spektori i Prokurimit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen: Drejtoria e Administratës- Spektori Teknik, Spektori i Prokurimit, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës  
Prof. dr. Ramadan Muja



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti**

**Komuna e Prizrenit**  
**Opština Prizren – Prizren Belediyesi**

Kryetari i Komunës  
Nr. 01/06-199281  
Më 17.11.2015

Kryetari i Komunës në mbledhjen e mbajtur më 17 nëntor 2015 me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik, për lejimin e shpalljes së tenderit për hapjen dhe zgjerimin e rrugës nga Kalaja deri te vendi i quajtur “Pasha Qeshme”, dhe mori këtë:


#### K O N K L U Z I O N

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik, për lejimin e hapjes dhe zgjerimit të rrugës nga Kalaja deri te vendi i quajtur “Pasha Qeshme”, kështu që, për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen: Drejtoria e Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik, Sektori i Prokurimit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen: Drejtoria e Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik, Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës  
Prof. dr. Ramadan Muja



Republika e Kosovës  
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Kryetari i Komunës  
Nr. 01/011-202081  
Më 17.11.2015



Komuna e Prizrenit  
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58, pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Emergjencë dhe Sigurisë për lejin e mjeteve për mbështetje financiare për Arbëresh Krasniqin, për renovimin e shtëpisë së djegur, kryetari i Komunës më 17 nëntor 2015, miratoi këtë:

#### V E N D I M

1. Miratohet propozimi i Drejtorisë së Emergjencë dhe Sigurisë, për lejin e mjeteve financiare për Arbëresh Krasniqin, për renovimin e shtëpisë së djegur, i evidentuar si rast social, kështu që, në emër të mbulimit të shpenzimeve lidhur me renovimet përkatëse, lejohen mjetet financiare në vlerë 2000 €.
2. Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe atë nga:
  - 2.1. Pozicionet buxhetore të kryetarit të Komunës, lejohen 1600 €, dhe
  - 2.2. Pozicionet buxhetore të Drejtorisë së Emergjencës dhe Sigurisë lejohen 400 €.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Emergjencës dhe Sigurisë dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.
4. Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtoria e Emergjencës dhe Sigurisë, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, i lartcekuri si dhe Arkivi.
5. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës  
Prof. dr. Ramadan Muja



Republika e Kosovës  
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Kryetari i Komunës  
Nr. 01/011-202086  
Më 17.11.2015




Komuna e Prizrenit  
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, për lejimin e mjeteve financiare për pagesë të faturës së KEDS-it, kryetari i Komunës, më 3 shkurt 2015 miratoi këtë:

#### V E N D I M

1. Miratohet propozimi i Drejtorisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, për lejimit të mjeteve financiare për pagesë të faturës së Kompanisë Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike (KEDS) në Prishtinë, për shkak të kyçjes në rrjetin elektrik të tri objekteve të banimit –banesave kolektive, të cilat gjenden në lagjen “Dardania”, kështu që, për këtë qëllim dhe në emër të pagesës së faturës përkatëse të Kompanisë, lejohen mjetet financiare në lartësi prej 4991.40 €.
2. Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve, mallrave dhe shërbimeve dhe shpenzimeve komunale të Drejtorisë së Punës dhe Mirëqenie Sociale dhe të Komunës.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Punës dhe Mirëqenie Sociale dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.
4. Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtoria e Punës dhe Mirëqenie Sociale, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, KEDS –i si dhe Arkivi.
5. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës  
Prof. dr. Ramadan Muja



Republika e Kosovës  
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Kryetari i Komunës  
Nr. 01/011-202091  
Më 17.11.2015



Komuna e Prizrenit  
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Njesisë për të Drejtat e Njeriut, për lejimin e mjeteve financiare për organizimin e aktiviteteve me rastin e Fushatës kundër dhunës në familje, kryetari i Komunës, më 17 nëntor 2015, miratoi këtë:

#### V E N D I M

1. Miratohet propozimi i Njesisë për të Drejtat e Njeriut, për lejimin e mjeteve për mbështetje financiare për organizimin e aktiviteteve me rastin e Fushatës kundër dhunës në familje. Në kuadër të këtyre aktiviteteve do të realizohet një tryezë e rrumbullakët me OJQ-të, do të mbahen (organizohen ) dy ligjërata me temën kundër dhunës në familje si dhe do përgatiten dhe shtypen broshura me mesazhe edukative, kështu që, për këtë qëllim lejohen mjetet e nevojshme financiare si në vijim:
  - 1.1. Për pagesë për dy ligjërata, lejohen mjete financiare në vlerë 100 €, dhe
  - 1.2. Për pagesë të broshurave-fletëpalosjeve, lejohen mjetet financiare në vlerë 50 €.
2. Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i mallrave e shërbimeve dhe subvencioneve të Komunës së Prizrenit.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Njësia për të Drejtat e Njeriut dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.
4. Me këtë Vendim të njoftohen: Njësia për të Drejtat e Njeriut, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave si dhe Arkivi.
5. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës  
Prof. dr. Ramadan Muja



Republika e Kosovës  
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Kryetari i Komunës  
Nr. 01/011-202096  
Më 17.11.2015




Komuna e Prizrenit  
Opština Prizren – Prizren Belediyesi


Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Njesisë për të Drejtat e Njeriut, për lejin e mjeteve për mbështetje financiare të Asamblesë së fëmijëve për zhvillimin e aktiviteteve të tyre, kryetari i Komunës, më 17 nëntor 2015, miratoi këtë:

#### V E N D I M

1. Miratohet propozimi i Njesisë për të Drejtat e Njeriut, për lejin e mjeteve për mbështetje financiare për organizimin e aktiviteteve të Asamblesë së fëmijëve. Në kuadër të këtyre aktiviteteve, Asambleja e fëmijëve, do të shfaq një program promovues për të drejtat e njeriut, në Shtëpinë e Kulturës “Xhemajli Berisha” në Prizren me datën 20.11.2015, do të përgatiten dhe shtypen banderola (pano) paluese afatgjata, me mesazhe të promovimit të të drejtave të fëmijëve, kështu që, për këtë qëllim lejohen mjetet e nevojshme financiare në shumën prej 200 €.
2. Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i mallrave e shërbimeve dhe subvencioneve të Komunës së Prizrenit.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Njësia për të Drejtat e Njeriut dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.
4. Me këtë Vendim të njoftohen: Njësia për të Drejtat e Njeriut, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave si dhe Arkivi.
5. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës  
Prof. dr. Ramadan Muja



Republika e Kosovës  
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit  
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Kryetari i Komunës  
Nr. 01/06-199281  
Më 17.11.2015

Kryetari i Komunës në mbledhjen e mbajtur më 17 nëntor 2015 me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Administratës, për lejimin e shpalljes së tenderit për furnizim me pajisje për punë të sallës së Kuvendit të Komunës, dhe mori këtë:

#### KON KLUZION

1. Miratohet propozimi i Drejtorisë së Administratës, bazuar në kërkesën e kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Prizrenit, për lejimin e furnizimit me pajisje të nevojshme për punë të sallës së Kuvendit të Komunës së Prizrenit, kështu që, për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit për:
  - 1.1. Furnizim me aparate dëgjimi –përkthimi (kufje).... 100 copë,
  - 1.2. Furnizim me foltore për konferenca..... 3 copë,
  - 1.3. Furnizim me Place Card.....50 copë.
2. Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen: Drejtoria e Administratës, Sektori i Prokurimit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.
3. Me këtë konkluzion të njoftohen: Drejtoria e Administratës, Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, kryesuesi i Kuvendit si dhe Arkivi.
4. Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës  
Prof. dr. Ramadan Muja





Republika e Kosovës  
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit  
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Kryetari i Komunës  
Nr. 01/06-199281  
Më 17.11.2015

Kryetari i Komunës në mbledhjen e mbajtur më 17 nëntor 2015 me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Shëndetësisë, për lejimin e shpalljes së tenderit për furnizim me uniforma, dhe mori këtë:


#### K O N K L U Z I O N

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Shëndetësisë, për lejimin e furnizimit me uniforma për nevojat e stafit të Kujdesit Primar Shëndetësor të Komunës së Prizrenit, kështu që, për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen: Drejtoria e Shëndetësisë, Sektori i Prokurimit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen: Drejtoria e Shëndetësisë, Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës  
Prof. dr. Ramadan Muja